

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 16 DHJETOR 2021

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuara zonja Xhixho,

Së pari, shumë faleminderit për shqetësimin e paraqitur dhe për mundësinë që më jepni që jo vetëm t'u përgjigjem pyetjeve tuaja, por të theksoj edhe një herë para jush, përpara prindërve dhe përpara të gjithë opinionit publik, se sa e rëndësishme është për ne që jo vetëm të rritim cilësinë e arsimit, por, së pari, të garantojmë mbrojtjen dhe mirëqenien e nxënësve, madje jo vetëm brenda mjediseve të shkollave tona, por edhe jashtë tyre, kudo ku mund të paraqitet rrezik për ta. Në lidhje me pjesën e parë të pyetjes suaj, po citoj: "Mbi çfarë kriteresh është bërë rekrutimi dhe emërimi i Engjëllush Bregut, i dënuar më parë për pedofili dhe ngacim seksual në shkollën "22 tetori" në Berat?". Më lejoni të theksoj që në fillim se edhe shqetësimi ynë, si ministri, ka qenë shumë i lartë për këtë ngjarje. Reagimi ishte i menjëhershëm. Unë, personalisht, e kam dënuar ashpër publikisht që në momentin e parë emërimin me kontratë të këtij mësuesi, sepse vërtet besoj fort që persona të tillë nuk duhet të hyjnë, qoftë edhe një orë të vetme, në mjediset e shkollave tona. Personi është larguar menjëherë nga detyra, vetëm 4 ditë pas lidhjes së kontratës. Pasi morëm edhe konfirmimin zyrtar nga gjykata për kryerjen e veprës penale, nisëm menjëherë një hetim administrativ për të gjetur personat përgjegjës që, me veprime apo mosveprime, kanë lejuar punësimin e tij. Por si ka qenë procedura për emërimin e këtij mësuesi?

Sipas informacionit të hollësishëm që kemi marrë nga zyra arsimore dhe drejtoria rajonale përkatëse, Engjëllush Bregu, diplomuar për Matematikë - Fizikë, ka filluar punë si mësues herët, që në vitin 1980, duke e vazhduar punën pa shkëputje për 23 vjet. Në vitin 2003, pas ngjarjes së ndodhur me nxënësit në shkollën 9-vjeçare Uznovë në Berat, ky mësues është proceduar penalisht dhe është dënuar me 7 muaj heqje lirie nga gjykata për vepra të turpshme. Por në vendimin e saj gjykata nuk ia ka hequr atij të drejtën e ushtrimit të profesionit, as në mënyrë të përhershme dhe as në mënyrë të përkohshme. Prandaj, qysh në atë kohë Drejtoria Arsimore Rajonale, duke mos disponuar asnjë vendim gjykate për heqje të të drejtës së profesionit dhe as ndonjë akt, udhëzim apo rregullore nga institucionet arsimore, ku të ndalohet një veprim i tillë, e ka rikthyer mësuesin në punë pas kryerjes së dënimit, pra që nga viti 2004 e deri në vitin 2009, kur ai më pas është larguar nga puna me dëshirën e tij. Në vitin 2017 mësuesi ka aplikuar përsëri konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në portalin "Mësues për Shqipërinë" dhe është punësuar që nga viti 2018 me kontrata të përkohshme. Së fundi, për vitin shkollor 2021-2022 Zyra Vendore Arsimore Berat e ka emëruar mësuesin me kontratë të përkohshme në shkollën "22 tetori" Berat. I përmenda këto fakte për të thënë se mësuesi nuk qenka rikthyer sot në punë pas ngjarjes së vitit 2003, por ka qenë vazhdimisht pjesë e sistemit tonë arsimor, përveçse një periudhe që ai vetë me dëshirën e tij është larguar, por më pas është rikthyer. Natyrisht, shqetësimi ynë kryesor nuk lidhet vetëm me anën profesionale të mësuesit, sepse zyra arsimore na ka

sjellë informacion të mjaftueshëm për ta justifikuar nga ana ligjore e procedurale emërimin e tij. Ajo që na shqetëson vërtet më shumë, është pjesa e dytë e pyetjes suaj: “Cilët janë mekanizmat që kemi për të garantuar mbrojtjen e nxënësve nga individë që mund të përbëjnë ende rrezik për nxënësit?”. Nisur nga zemërimi i lartë publik apo mediatik, që është plotësisht i drejtë, por edhe nga detyrimi ynë dhe i të gjitha institucioneve arsimore për sigurinë e fëmijëve në shkolla, vetëm pak ditë pas ngjarjes, në datën 1 dhjetor firmosa udhëzimin që ndalon aplikimin dhe konkurrimin për të punuar si mësues të personave të dënuar për të cilët gjykata ka marrë vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore. Ky vendim ka për qëllim të shmangë rrezikun që mund t’u vijë nxënësve tanë nga persona që nuk garantojnë integritet të lartë moral e ligjor. Por a shmanget plotësisht rreziku me këtë udhëzim? Çfarë ndodh në rastet kur kandidatët janë dënuar vite më parë nga gjykata për veprat e mësipërme penale, por që me kalimin e kohës rehabilitohen? Sepse edhe në rastin konkret dokumentacioni i dorëzuar nga mësuesi në momentin e aplikimit përmban edhe dëshminë e penalitetit, ku rezultojnë që ai ishte i padënuar dhe nuk disponojmë asnjë informacion tjetër zyrtar për veprën konkrete penale për të cilën ishte dënuar 18 vjet më parë, pasi Kodi Penal, siç e dimë të gjithë parashikon rehabilitimin e një personi të dënuar, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara. Pikërisht për këtë qëllim, kam biseduar që ditën e parë edhe me ministrin e Drejtësisë, zotin Ulsi Manja, për të ndërmarrë së bashku një iniciativë ligjore që disa vepra penale të rënda, duke përfshirë edhe këto të rastit në fjalë, të mos fshihen asnjëherë nga dëshmia e penalitetit apo qoftë të gjejmë një mekanizëm edhe më të fortë që të garantojmë mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve tanë, madje këtu jam shumë e hapur të mirëpres edhe sugjerimet tuaja, sepse siguria e fëmijëve është një temë që duhet të kapërcejë çdo interes tjetër, politik apo partiak. Natyrisht, jam shumë e hapur edhe për propozimin tuaj për regjistrin. Patjetër, këtë ligj duhet ta shikojmë të gjithë me përparësi dhe, nëse ndihmon për zgjidhjen e kësaj problematike, jam plotësisht dakord që ta votoj jo vetëm unë, por do t’ju kërkoja të gjithëve që ta votojmë sa më parë.

Aktualisht, në ekipet e shkollave tona, tashmë prej vitesh, kemi edhe punonjës psikosocialë, kemi oficerë sigurie, kemi mësues ndihmës që, së bashku me drejtorin e shkollës dhe me të gjithë mësuesit, punojnë çdo ditë në këtë drejtim. Por një iniciativë e re ligjore, që e shmang totalisht rrezikun, është pa diskutim e domosdoshme dhe ne do ta ndërmarrim shumë shpejt me kolegun Manja, sepse, siç e theksova që në reagimin tim të parë për këtë çështje, për ne mbrojtja e nxënësve është e shenjtë dhe nuk do të tolerojmë askënd që cenon mirëqenien e tyre. Kur ta sjellim këtë iniciativë ligjore këtu në parlament, do të shpresoja shumë që të kemi edhe mbështetjen tuaj. Faleminderit!